



THIRRJE PËR PJESËMARRJE

NË

“KONFERENCA E X-TË MJEKËSORE NDËRKOMBËTARE NË SPECIALITETE”

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

*Nën kujdesin e veçantë të Rektorit të Universiteti të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Prof.dr. Skender TOPI*

Në bashkëpunim me:



23 - 24 - 25 Nëntor 2018

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në bashkëpunim me Universitetin e Aquila dhe Universitetin e Barit, Itali, organizojnë për të 10-in vit rradhazi, Konferencën Mjekësore Ndërkombëtare në Specialitete. Në këtë konferencë pritet të marrin pjesë rreth 250 lektorë, shqipëtarë e të huaj, të cilët në dy ditët e zhvillimit të saj, do të prezantojnë punimet e tyre kërkimore shkencore për një auditor të gjërë.

Konferencën e X-të Mjekësore Ndërkombëtare në Specialitete, fton akademikë, mjekë, infermierë, farmacistë, stomatologë, psikologë, punonjës socialë, e të tjerë studiues, për të marrë pjesë e për të ndarë njohuritë, perspektivat dhe tendencat e reja të hulumtimeve në fushat përkatëse. Kjo konferencë është e akredituar dhe të gjithë relatorët e pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata dhe kreditet përkatëse.

Seancat që do të mbahen në konferencë:

- a-Seanca plenare
- b-Sesionet tematike

Data të rëndësishme:

<i>Dërgimi i abstraktit</i>	15 Shtator 2018
<i>Dërgimi i punimit të plotë</i>	20 Tetor 2018
<i>Data e konferencës</i>	23 – 24- 25 Nëntor 2018

Vendi: Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan.

Gjuha e konferencës: Shqip, Italisht, Anglisht.

Kreditet e konferencës : Relatorët në konferencë do të pajisen me 36 kredite.
Pjesëmarrësit në konferencë do të pajisen me 18 kredite.

CV e Relatorit : të gjitha abstraktet e dërguara duhet të shoqërohen nga CV e relatuesit të punimit.

Linku për tarifën dhe mënyrën e pagesës:

<http://uniel.edu.al/Fature-p%C3%ABr-ark%C3%ABtim-Konferenca-shkencore.pdf>

Kontakte:

Për çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni:	konferencafshmt2018@uniel.edu.al
Për dërgimin e materialeve, ju vëmë në dispozicion adresat e mëposhtme:	prof.skendertopi@yahoo.it konferencafshmt2018@uniel.edu.al

Do të ishim mirënjohës nëse ju e ndani këtë Thirrje për Pjesëmarrje në Konferencë edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj.

Ju falenderojmë për interesimin tuaj!

UDHËZIME PËR ABSTRAKTIN E PUNIMIT

TITULLI I PUNIMIT

(14points Times Neë Roman, Bold, Centered, Uppercase)

Emër Mbiemër

Pozicioni i punës, emri i institucionit, shteti, adresa e email (12 Points, Times Neë Roman, Bold, Centered)

Emrër Mbiemër¹, Emër Mbiemër², Emër Mbiemër³

(12 Points, Times Neë Roman, Bold, Centered)

¹Pozicioni i punës, emri i institucionit, shteti, adresa e email(12 Points, Times New Roman, Bold, Centered)

² Pozicioni i punës, emri i institucionit, shteti, adresa e email(12 Points, Times New Roman, Bold, Centered)

³ Pozicioni i punës, emri i institucionit, shteti, adresa e email(12 Points, Times New Roman, Bold, Centered)

Abstrakti i punimeve duhet të paraqitet në një paragraf, në gjuhën Angleze, pavarishtë gjuhës që keni zgjedhur për ta trajtuar punimin. Ai duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës, dhe me seksionin përkatës, qasjen e përdorur, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre. Përmbajtja e abstraktit duhet të jetë 250 - 300 fjalë (12pt Times New Roman, Bold, Justify, Hapësira mes rreshtave 1.5) dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet. Fjalë kyçe duhet të jenë minimalisht 5 dhe maksimalisht 7, të renditura alfabetikisht (12pt Times New Roman, Normal). Fjalët kyç është mirë që të përmbledhin temën, nëntemën, llojin e studimit, popullatën, vendin e zbatimit të studimit. Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word, shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës:12 pt., font - Times New Roman.